

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR KORCE

NR.REGJISTRITHEMELTAR 71009-0672-41-2015  
(276)  
DATA E REGJISTRIMI 26.05.2015

NR.VENDIMI 276  
(41-2015-2224)  
DT. VENDIMI 08.06.2015



**VENDIM**  
**“NE EMER TE REPUBLIKES”**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Korce, e perbere prej:

**MILIANA MUÇA** - Gjyqtare e vetme

asistuar nga sekretare seances gjyqesore Zamira Shkempi, ne Korce, sot me dt.08.06.2015, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore me dyer te hapura kerkesen penale me numer regj. 276 date 26.05.2015, ne prani te prokurores Dhorina Theodhori, qe iu perket:

**KERKUES:** Thomas Mihael Machairidis, i biri i Mihailit, dtl. 1962, lindur ne Xanthi, Greqi dhe banues ne Selanik, Greqi, perfaqesuar me prokure nga avokati Arben Lena, Dhoma e Avokatisë Korce.

**IDYSHUAR:** Per kryerjen e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale ose te vepimitarise kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

**OBJEKTI:** Heqjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi llogarine bankare prane “Procredit Bank” Sh.A.

**BAZAL LIGJORE:** Nenet 274/3 i te K.Pr.Penale.

Gjykata, pasi shqyrtoi kerkesen e te dyshuarit Thomas Mihael Machairidis, nepermjet perfaqesuesit te tij si dhe konkluzionet perfundimtare ku u kerkua heqjen e mases se sekuestros preventive dhe prokuroren qe kerkoi rrezimin e kerkeses,

**VEREN:**

Peroni nen hetim Thomas Mihael Machairidis, nepermjet perfaqesuesit te tij me prokure, avokatit Arben Lena, ka paraqitur per gjykim ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Korce kerkesen me objekt heqjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros preventive te dhene ndaj tij me vendimin gjyqesor nr. 189 regj. date 02.05.2014 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korce.

**Lidhur me vendosjen e kesaj mase:**

Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korce i ka paraqitur kesaj gjykate me date 30.04.2014 kerkesen per gjykim me objekt: “Vendosjen e mases e sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi llogarite bankare te shtetasit Grek Thomas Mihael Machairidis prane bankes



Procredit " Bank Sh.A., dega Bilisht ne llogarite e tij me numer 531656420002 dhe 531656420102".

Kjo gjykate me vendimin nr. 189 regj. date 02.05.2015 ka vendosur:

Pranimin e kerkeses se Prokurorise prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korce, duke vendosur mases e sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi llogarite bankare te shtetasit Grek Thomas Mihael Machairidis prane bankes " Procredit " Bank Sh.A., Dega Bilisht ne llogarite e tij me numer 531656420002 dhe 531656420102.

Personit te interesuar, pra kerkuesit ne kete gjykim Mihael Machairidis, ky afat ankimi i eshte specifikuar ne vendim se i fillon nga dita e marrjes dijeni. Kunder ketij vendimi, ai nuk rezulton te kete bere ankim dhe per pasoje vendimi ka marre forme te prete i paankimuar.

Kjo mase sigurimi me karakter pasuror lidhet me regjistrimin nga Prokuroria prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Korce te procedimi penal nr.1153/viti 2014, mbi bazen e materialit hetimor te derguar nga ana e Drejtorise se Policise se qarkut Korce, per vepren penale te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, "*pastrimi i produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale*".

Rezulton se Drejtoria e Krimet Ekonomik ka marre informacion ne lidhje me shtetasin grek Thomas Mihael Machairidis. Sipas ketij informacioni, me dt.23.12.2013 ky shtetas ka hapur nje llogari ne banken "*Pro Credit*", dega Bilisht, ku ka deklaruar se ai merrej me aktivitet tregtar "*shitje skrap*", nga ku ka patur, sipas tij, te ardhura financiare.

Ne vijim, me dt.14.01.2014 atij i jane transferuar rreth 28.342 euro nga llogaria ne Qipro e kompanise "*Sunset Bisines Sevices LDT*", ndersa me dt.24.04.2014, po nga kjo llogari, i jane transferuar 79.775 euro.

Pas kerkeses se Bankes per shpjegime lidhuri me burimin e ketyre transaksioneve financiare, nga ane shtetasit grek Thomas Mihael Machairidis eshte paraqitur nje marreveshje huaje e dt.12.01.2014, e hartuar vetem dy dite para pageses se pare.

Rezulton se kompania "*Sunset Bisines Sevices LDT*" eshte regjistruar me seli ne Belize, e themeluar me dt.08.02.2011, nr.regjistrimi 10.16.74, me drejtor te pergjithshem Marie Pasvandi. Kjo kompani ka rene dakord qe t'i jape nje hua prej 250.000 eurosh me 3 % interes shtetasit Thomas Mihael Machairidis, hua e cila do t'i levrohej ne llogarine qe ky i fundit kishte ne banken "*Pro Credit*" ne Shqiperi. Sic eshte pershkrua ne permbajtjen e kesaj marreveshjeje (referuar informacionit per referimin referimit te vepres penal ), ajo eshte ne shkruar nga te dyja palet, duke parashikuar se i nenshtrohet legjislacionit te brendshem ne Qipro.

Nga verifikimet, nuk rezultojne transaksione ne emer dy subjekteve te mesiperme kompania "*Sunset Bisines Sevices LDT*" dhe Thomas Mihael Machairidis. Po keshtu, nga regjistri i hyrje - daljeve rezulton se ky i fundit ka hyre ne territorin shqiptar nepermjet Pikes se Kalimit Kufitar ne Kapshtice vetem me dt.16.01.2014, dite ne te cilen jane kryer veprime ne banke.

Ne funksion te ketij procedimi, eshte kerkuar nga ana e prokurorise informacion me shkrim prej Drejtorise Rajonale Tatimore Korce, e cila me shkresen nr.6178, dt.30.04.2014 ka konfirmuar se shtetasi Thomas Mihael Machairidis nuk figuron te jete i regjistruar ne ndonje aktivitet financiar,



si person fizik, dhe as si administrator i ndonje subjekti juridik ( ndryshe nga sa ka deklaruar para filialit te bankes ne Bilisht ).

E njehta rrethane ka rezultuar edhe nga kerkimet e prokurorise si organ procedues prane OKR-se, ku ky shtetas nuk rezulton te jete subjekt tregtar “ ( citim nga vendimi gjyqesor ).

Avokati i personit nen hetim Thomas Mihael Machairidis pretendoi heqjen e kesaj mase sigurimi pasuror me karakter shterngues, duke referuar ne nenin 274 pika 3 te K.Pr.Penale:  
“ Kur ndryshojne kushtet e zbatimit, gjykata, me kerkesen e prokurorit ose te interesuarve, e heq sekuestron “.

Prej tij pretendohet:

- Thomas Mihael Machairidis merret me biznes skrapi ne Greqi dhe se eshte i regjistruar si person juridik ne autoritet Greke, duke paraqitur per kete dokumentacionin e regjistrimit nga Dhoma e Tregtise dhe Indidustrise Greqi per shoqerine anonime “ Al metal Embroio Metalon Anonimos Eteria “ me perfaqesues ligjor Thomas Mihael Machairidis.
- Thomas Mihael Machairidis eshte paraqitur vete para organit procedues dhe ka dhene deklarime lidhur me aktivitetin e tij tregtar, faktin se shuma e kaluar ne “ Procredit “ Bank prej 280.000 euros eshte kredi e marre nga kompania “Sunset Bisines Sevices LDT” .
- Thomas Mihael Machairidis dhe kompania “Sunset Bisines Sevices LDT” ka dashur te hyje ne marredhenie pune me nje shtetas shqiptar, i cili e ka mashtruar dhe prej tij do te blinte nje sasi bakri qe kushtonte 160.000 euro, por atij nuk ia di emrin dhe nuk ka mundesi kontakti.
- Shuma e bllokuar Thomas Mihael Machairidis nuk eshte 250.000 euro sikurse eshte pretenduar, por aktualisht vetem 40.000 euro.
- Nga deklarimet e shtetasit Mareglen Myrtollari vertetohet tratativa tregtare, por ato kane deshtuar, pasi me personin e pare qe kishte kontaktuar nuk ka pasur me mundesi kontakti ( pasi mund te kete dashur dhe ta mashtronte ) ndersa shtetasi Mareglen Myrtollari nuk e kishte mallin qe i interesonte Thomas Mihael Machairidis.
- Fondet financiare te marra kredi nga “Sunset Bisines Sevices LDT” pavaresisht se jane marre nga nje kompani me qender ne Belize, Qipro, nuk vertetohet ate cka pretendon prokuroria, por kjo kredi eshte marre atje per shkak te interesave te uleta qe kane kompanite financiare te ketij vendi.
- Ne keto kushte, pretendohet se provohet fakti se shuma mbi te cilen rendon aktualisht nje mase sigurimi pasuror, ajo e sekuestrimit preventiv, lidhet me aktivitetin tregtar te subjektit tregtar te perfaqesuesuar nga Thomas Micharidis, dhe qellimi i kalimit te kesaj shume ne “ Procredi “ Bank ka qene i ligjshem.

Ndersa perfaqesuesja e prokurorise parashtrori:

- Pas marrjes se vendimit gjyqesor per vendosjen e sekuestrimit konservativ, personi i dyshuar Thomas Micharidis ka arritur te terheqe dy here nga 40.000 euro dhe per kete punonjesit e bankes qe e kane lejuar kete veprim eshte regjistruar nje procedim penal, i deleguar per kompetence prane Prokurorise se Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.
- Prokuroria e ka pare te arsyeshme te nise leterporosite ne autoritet Qipriote per tu informuar dhe per tu percjelle dokument qe i perkasin kontrates date 12.01.2014 per dhenie kredie ( te sjelle nga Thomas Micharidis, por jo ne formen e duhur ligjore ) si dhe informacion me te rendesishem lidhur me kete fakt. Gjithashtu dhe autoritetet Greke, po nepermjet leterporosise iu eshte kerkuar informacion mbi aktivitetin tregtar te te dyshuarit Thomas Micharidis dhe kompanise, te dhena mbi llogarite bankare, aktivitetin dhe fitimet, aktivitetin e importimit dhe eksportimit qe



mund te kryeje ky subjekt. Prokuroria argumentoi se ketyre leterporosive iu eshte hapur rruge, por nuk jane kthyer ende pergjigje.

- U pretendua se nuk ka eshte zbehur dyshimi ndaj Thomas Micharidis lidhur me vepren penale te pastrimit te produkteve te vepres penale ose te veprimtarise kriminale, por ky dyshim eshte perforcuar. Deklarimet e tij te dhena para organit procedues se kredia e marre ka synuar te konkretizojte nje marredhenie tregtare me nje person qe nuk identifikohet, behen te dyshimta pasi nuk ka nje kontrate, apo marreveshje te lidhur ndermjet tyre. Pervec kesaj pretendohet se Thomas Micharidis ka konsumuar dhe nje veper tjeter penale pasi vleren e terhequr nga "Pro Credit" e ka kaluar ne territorin Grek dhe nuk e ka deklaruar ne doganen tone dhe pervec kesaj behet i dyshimte kur deklaroi se 80.000 euro i ka perdorur per nevojat e tij.
- Prokuroria argumentoi se duhet sqaruar nepermjet leterprosise dhe nese kjo shume eshte deklaruar ne shtetin grek, megjithese nuk ka rezultuar e deklaruar ne doganen tone.
- Sa me lart, argumentohet se nuk ka vend per heqjen e mases se sekuestros preventive dhe se duhet rrezuar kerkesa obehjekt gjykimi.

**Sa me lart, gjykata vlereson se kerkesa e personit nen hetim Thomas Micharidis per heqjen e mases se sigurimit pasuror, sekuestros preventive duhet rrezuar per dy arsye:**

**Se pari:**

Ka ekzistuar dhe ekziston nje dyshim i arsyeshem per ekzistencen e figures e vepres penale te pastrimit te produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal. I vetmi moment i sqaruar nga hetimi eshte fakti se Thomas Micharidis perfaqeson nje person juridik te regjistruar ne shtetin grek, rrethane qe nuk shmang dyshimin ne ngarkim te tij per secilen nga pikat e nenit 287, si elemente te anes objektive a-d. me ndryshimet e bera me ligjin nr. 23/2012:

*Pastrimi i produkteve te vepres penale ose veprimtarise kriminale, nepermje:*

*a) kembimit ose transferimit te pasurise, me qellim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme te saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale;*

*b) fshehjes ose mbulimit te natyres së vertete, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose te drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale;*

*c) fitimit te pronësisë, posedimit ose perdorimit te pasurise, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i vepres penale ose i veprimtarise kriminale;*

*ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;*

*d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të vepres penale ose veprimtarise kriminale;*

Ky dyshim per secilen nga format e anes objektive te sipercituara perforcohet nga fakti se eshte provuar tashme se vlera e terhequr prej tij, 80.000 euro ka kaluar ne territorin grek jo nepermjet nje veprimi bankar, por dorazi, madje as nuk eshte deklaruar ne doganon tone. Kjo rrethane provohet nga deklarimet e vete shtetasit te dyshuar te dates 17.04.2015 si i ka shpenzuar per nevojat e tij.



Moment tjetër që përforcon dyshimin është dhe mungesa e një akti të shkruar me një person që nuk jepet asnjë e dhënë për zhvillimin e një aktivitetit tregtar, për ushtrimin e të cilit nevojitet një vlerë kaq e madhe. Sipas vete të dyshuarit janë nënshkruar tre kontrata kredie me "Sunset Business Services LDT" me të njëjtën datë, e para për një shumë prej 300.000 euro, e dyta 250.000 euro, e treta 120.000 euro, pasi nuk dihej prej tij sa do të duheshin për aktivitetin në Shqipëri.

Nuk duhet të lihet në harresë fakti se këto dyshime duhen parë të lidhura me faktin se nga autoritetet greke dhe qipriote, organi i akzues është në pritje të përgjigjeve të lehtëporosise. Ajo që vihet re, referuar kerkimeve të organit procedues është se autoritetet greke nuk u është kërkuar vetëm dokumentacioni që provon ekzistencën e personit juridik të përfaqësuar nga Thomas Micharidis (që u sollën si prova nga ky i fundit në këtë gjykim), por dhe gjendja pasurore, aktivitetet e këtij subjekti, të dhëna nga bankat e nivelit të dytë mbi llogaritë bankare etj. Ndërsa autoritetet qipriote, përveç praktikës së huasë dhe: menyra, sasia, vendit dhe institucionit bankar në të cilin është kryer levrimi i shumave të huasë, apo dhe pagesave të kryera në kuader të kësaj marrëveshje (shih përmbajtjen e kërkesave për ndihmë juridike).

Në këto kushte, gjykata arsyeton në kuadrin e "dyshimit të arsyeshëm" se nuk ka ndryshuar kushtet e zbatimit masës së sigurimit pasuror të dhënë me vendimin gjyqësor nr. 189 regj. date 02.05.2014.

**Se dyti:** Gjykata arsyeton se masat e sigurimit pasuror kanë specifikën e tyre, pasi shtihen mbi sendet që shërbejnë ose kanë qenë të desituara për të kryer një veprë penale ose kanë qenë prodhim ose përfitim nga vepra penale.

Pra, në, ndryshim nga masat e sigurimit personal, kur me zbutjen e nevojave të sigurimit mund të jepet një masë tjetër me e butë, kjo nuk vlen për masat e sigurimit pasuror. Kjo do të thotë, se nëse hiqet kjo masë siguri, shtetasi nën hetim Thomas Micharidis do të ndërheqë këtë shumë, sikur dhe ka bërë dhe dy herë të tjera (pas vendosjes së sekuestros) dhe kjo vlerë do të shërbejë zgjatjes së pasojave të veprës penale për të cilën ai vazhdon të jetë i dyshuar, pastrimin e produkteve të veprës penale ose të veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal.

Nga interpretimi i nenit 275 të Kodit Penal, rezulton se nëse konkludohet në dënimin e personit, sendet në të cilat ishte vendosur sekuestro preventivë konfiskohen.

Nëse në përfundim të këtij hetimi, do të konkludohet për pafajësinë apo pushimin e çështjes, gjykata ose prokurori urdheron që sendet e sekuestruara të kthehen atij që i takojnë.

Nëse kjo gjykatë, do të dispononte në pranimin për heqjen e masës së sekuestros preventivë, ndërsa hetimet vazhdojnë pasi vijon të ekzistojë dyshimi i arsyeshëm për ekzistencën e veprës penale, i dyshuari, sikurse u arsyetua do të terhqite vlerën e sendeve të cilat mund të jenë produkt i veprës penale.

Sa me lart, gjykata cmon seriozisht si të domosdoshme masën e sigurimit me karakter pasuror të dhënë me vendimin nr. nr. 189 regj. date 02.05.2014 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korce dhe nuk ka vënd heqjen e saj, duke rrezuar kështu kërkesën e personit nën hetim Thomas Mihal Machairidis.

**PER KETO ARSYE,**

Gjykata mbeshtetur ne nenet 244 – 245, 274 te K.Pr.Penale,

**VENDOSI:**


1. Rrezimin e kerkeses se personit nen hetimi Thomas Mihael Machairidis, me objekt heqjen e mases se sigurimit pasuror te sekuestros preventive mbi llogarine bankare prane “ Procredit Bank” Sh.A.
2. Shpenzimet gjyqesore sic jane bere.
3. Kunder ketij vendimi mund te behet ankim ne Gjykatën e Apelit Korçe brenda 10 diteve duke filluar ky afat nga e nesermja e shpalljes se vendimit.

U shpall ne Korçe sot me dt. 08.06.2015 ora 08.50.

**SEKRETARE  
ZAMIRA SHKEMBI**



**G JYQTARE  
MILIANA MUÇA**



Shenim ; Mbi ankim Gjykata e Apelit Korçë me vendim N r 33 date 21.07.2015 vendosi;

Lenien ne fuqi të vendimit nr 276 date 08.06.2015 te Gjykates së Rrethit Gjyqësor Korçë

Korçë, më 16.09.2015

**KANCELARI**

**LIGORAQ TOSHI**



Shenim: Mbi rekurs Gjykata e Lartë Tiranë me vendim Nr 2478 date 13.10.2015 vendosi :

Mospranimin e rekursit të paraqitur nga Thomas Mihal Macharidis, kundër vendimit Nr 33 datë 21.07.2014 të Gjykatës së Apelit Korçë

Korçë, më 16.12.2015

KANCELARI

LIGORAQ TOSHI



VERTETOHET

NJESIA E

FOTOKOPJES

ME ORIGINALIN

KORÇE ME 25.11.2020

*gë ndodhet në dosje*

Arhiviste *Marimete Cenalli*

